

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Djali i Jakup Krasniqit tregon mesazhin që ia dha i ati, ja çfarë i tha
ADRESA	https://www.gazetatema.net/rajoni/djali-i-jakup-krasniqit-tregon-mesazhin-qe-ia-dha-i-at-i-ja-çfare-i-tha-eu-i586323
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 17:57:27 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 17:57:14 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	bcc594311dfcf02206627d945704697dea76e3e0b0364b29d507b5d721a90f
TEKSTI	34e66ae43340dd80247d2db69cfd45bee666992383481687b89ac8d71b88d91
PAMJA	4aa295837d29cfff4e354642c2824859d707ead0903543e7596add96b678accae

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	170d31b508a609bee45cc58c83306d86b8c11040f2e7fa6baba44ff3a1b9cd29
E MËPARSHMJA	74b97a2dd85551edf747a3d7a4607f7fe0f7c7d4c698d15890508d93ae1af4c5
RRËNJA MERKLE	80f8ed3d4c77708449a259db492a6c9a12b9addcfc62e639a2bd2cb31edd1709
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/170d31b508a609bee45cc58c83306d86b8c11040f2e7fa6baba44ff3a1b9cd29>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



ie Rama publikon totot nga ceremonia e inaugurimit te Konsullates se Nderit te Shqiperise ne Napoli, zbulon dhuraten e vecante qe morr "Daja i deputetes me ka perdhunur fundit

Djali i Jakup Krasniqit tregon mesazhin që ia dha i ati, ja çfarë i tha

TemA

15 Shtator 2026, 19:57Rajoni TEMA



Kur kanë mbetur më pak se 15 orë deri në shpalljen e vendimit të shkallës së parë të Gjykatës Speciale për ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, djali i Jakup Krasniqit, Altini, ka thënë se këto orë do ta kenë një rëndësi shumë të madhe.

Ai tha se lufta e UÇK-së ka qenë e pastër, e drejtë dhe beson se krerët e saj kanë bërë luftë për dinjitetin e popullit shqiptar.

Krasniqi tregoi edhe për mesazhet dhe kurajon që ia ka dhënë i ati, Jakupi, duke thënë se ai është shprehur se lufta e secili bashkëluftëtar ka qenë e drejtë dhe për lirinë e popullit shqiptar.

"Sa herë jemi takuar me babin gjithmonë na ka dhënë motiv dhe na ka dhënë një kurajo. Ka thënë që lufta e UÇK-së, jo veç e imja, por e secilit ushtar dhe secilit që është duke u gjykuar këtu, ka qenë e drejtë, për dinjitet dhe për lirinë e popullit shqiptar. UÇK-ja ka bërë luftë të pastër edhe nuk ka asnjë vendim që mundet me ndryshuar krenarinë që ka ky popull për këtë Ushtri Çlirimtare të Kosovës", tha Krasniqi për KosovaPress.

Më tej ai tha se e ka ëndërruar lirinë e babait të tij dhe se ndiejnë dhimbje pasi ai është në paraburgim, por shtoi se dhimbja më e madhe do të ishte nëse Jakup Krasniqi nuk do të kishte qenë pjesë e UÇK-së.

Normal unë e kam ëndërruar, unë jam shumë krenar për rrugën që ka zgjedhur baba im. Unë normal që ndiej dhimbje, po dhimbja ime më e madhe do të ishte nëse babai im nuk kish qenë pjesës së, pjesë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe pjesë e shtetndërtimit të Kosovës, kështu që jam krenar çfarëdo që vendimi të merret sot, ai dhe shokët e tij kanë me qenë heronjtë e Kosovës dhe kanë me qenë krenaria e jonë", tha ai.

Krasniqi tutje u shpreh se do ta apelojnë çdo vendim që nuk do të jetë në favor të ish-krerëve të UÇK-së, ndërsa në rast se vendimi nuk është pozitiv, ai duhet marrë me qetësi dhe me maturi.

Duhet të jemi bashkë, kjo është përtej politikës, duhet me u larguar prej përçarjeve që i kemi në këto momente si popull, duhet me u bë bashkë edhe vetëm bashkë mundemi me ecur përpara, me zhvilluar vendin tonë edhe me krijuar një vend që është demokratik, po, me krijuar një vend që ec përpara. Ne si familje

dhe pjesa e ekipes tone mbrojtese do te apeloje çdo vendim qe nuk eshte i drejte. Besoj qe duhet me u marre me qetes, me maturi dhe me shikuar çtare po ndodh nesër. Prova nuk ka, dëshmi nuk ka që e inkriminon luftën e UÇK-së, edhe çdo vendim që nuk është në pafajësinë e tyre është i padrejtë dhe politik", u shpreh Krasniqi.

Seanca ku do të jepet vendimi i shkallës së parë për Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Jakup Krasniqin dhe Rexhep Selimin do të nisë nesër me fillim nga ora 10:00.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Sa pushtet kishin? Thaçi dhe të tjerët para verdiktit

19:30 Rajoni

Frika nga tensionet për vendimin ndaj krerëve të UÇK, dy avionë të KFOR-it arrijnë në Kosovë

19:02 Rajoni / 2 komente

[FOTO/ "Çlirimtarë, sillni në shtëpi" - Kosova 'vishet' me flamuj e portrete para aktgjyimit në Hagë](#)

18:15 Rajoni / 3 komente

Verdikti për Thaçin dhe ish-krerët e UÇK-së, spitali më i madh në Kosovë merr masa paraprake

17:35 Rajoni / 1 koment

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.